



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2022-01

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 24 maj 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Kai Ambos

Gjykatëse Nina Jorgensen

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Hysni Gucatit:

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), në bazë të neneve 33(1)(c) dhe 46 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 172 dhe 173(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit për të vendosur lidhur me Kërkesën e Haradinajt për Sqarim lidhur me Afatet e Apelit (“Kërkesa”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykues II nxori Versionin e Redaktuar Publik të Aktgjykimit (“Aktgjykimi”), ku, ndër të tjera, shpalli fajtor z. Nasim Haradinaj për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, nëpërmjet kërcënimit të rëndë, pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, dhe frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, nëpërmjet zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë, identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.² Trupi Gjykues e dënoi z. Haradinaj me katër vjet e gjysmë burgim dhe me një gjobë prej 100 eurosh.³

2. Më 23 maj 2022, z. Haradinaj dorëzoi Kërkesën.

II. CAKTIMI

3. Pas shqyrtimit të kritereve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe

¹ F00001, Kërkesë e Haradinajt për Sqarim lidhur me Afatet e Apelit, 23 maj 2022.

² KSC-BC-2020-07/F00611, Aktgjykim, 18 maj 2022 (konfidencial), para. 1015. Versioni i Redaktuar Publik i Aktgjykimit u dorëzua në të njëjtën ditë. Shih KSC-BC-2020-07/F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022.

³ Aktgjykimi, para. 1017.

disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:

Gjykatësen Mishelë Pikar

Gjykatësin Emilio Gati

Gjykatësen Nina Jorgensen

në panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi Kërkesën dhe parashtrimet e protokolluara lidhur me njoftimin për apel në këtë çështje gjyqësore, nëse do të ketë të tilla.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E martë, 24 maj 2022
Hagë,
Holandë